

Për zhvillimin e testimit për vlerësues dëmsh në sigurime

Në zbatim të nenit 227 pika 1/dh të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe nenit 7, të Rregullores nr.35, datë 27.03.2019, “Mbi organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në AMF”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, njofton të gjithë të interesuarit, se:

Më datë **26 mars 2024**, do të zhvillohet testimi për rinovim të licencës së vlerësuesit të dëmeve në sigurime si dhe testimi për pajisje me licencë të personave fizik që aplikojnë për licencë si vlerësues dëmsh në sigurime.

Në testim do të marrin pjesë të gjithë ata aplikantë (për rinovim apo licencë të re) që plotësojnë të gjitha kërkesat e Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 dhe Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017, “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar.

Për detaje lidhur me zhvillimin e testeve aplikantët që plotësojnë kërkesat ligjore do të njoftohen paraprakisht.

Për më tepër informacion kontaktoni amf@amf.gov.al.